

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Mars 2018

Tiranë, më 23 Prill 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Mars 2018, është 607.287. Krahasuar me Mars 2017, ky tregues rezulton me rritje 3,8 %.


Në Mars 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 254.019. Krahasuar me Mars 2017, ky numër është rritur me 4,3 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë, në tremujorin e parë e 2018, është 676.888, duke u rritur me 12,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Mars 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Gjermania ka patur rritjen më të madhe me 36,4 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Maqedonia me 11,9 %.

Në tremujorin parë 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Gjermania ka patur rritjen më të madhe 18,8 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Mars 2018, janë 598.992, duke shënuar një ulje me 5,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Mars 2018, është 364.264. Krahasuar me Mars 2017, ky numër është ulur 3,6 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Mars 2018, është 234.728. Krahasuar me Mars 2017, ky numër është ulur 8,3%.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë, në tremujorin parë 2018, është 1.111.856, duke u rritur 6,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Mars 17	Mars 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Mars 17	Janar- Mars 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	584.780	607.287	3,8	1.517.427	1.706.295	12,4
Shqiptarë	341.318	353.268	3,5	915.487	1.029.407	12,4
Të Huaj	243.462	254.019	4,3	601.940	676.888	12,5
Dalje gjithsej	633.894	598.992	-5,5	1.673.616	1.820.400	8,8
Shqiptarë	377.793	364.264	-3,6	1.046.113	1.111.856	6,3
Të Huaj	256.101	234.728	-8,3	627.503	708.544	12,9

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Mars 17	Mars 18	Ndryshim vjetor (%)	Janar- Mars 17	Janar- Mars 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	81.196	85.232	5,0	201.699	225.919	12,0
Maqedoni	40.191	35.417	-11,9	95.305	98.176	3,0
Greqi	33.261	37.736	13,5	84.576	98.719	16,7
Itali	18.345	20.444	11,4	49.603	55.663	12,2
Angli	4.468	5.147	15,2	11.660	13.267	13,8
Mali i zi	31.822	25.429	-20,1	74.360	75.302	1,3
Poloni	445	495	11,2	1.032	1.219	18,1
SHBA	3.723	3.870	3,9	9.350	10.146	8,5
Gjermani	3.342	4.557	36,4	7.974	9.474	18,8
Zvicër	1.151	1.298	12,8	3.581	3.858	7,7
Të tjera	25.518	34.394	34,8	62.800	85.145	35,6
Gjithsej	243.462	254.019	4,3	601.940	676.888	12,5

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Mars 17	Mars 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Mars 17	Janar- Mars 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrije Shtetas të Huaj	243.462	254.019	4,3	601.940	676.888	12,5
I. Personale	237.995	247.710	4,1	589.827	661.508	12,2
1. Pushime	66.589	32.792	-50,8	114.858	97.277	-15,3
2. Vizitë në miq e të afërm	967	1.503	55,4	2.202	2.970	34,9
3. Vizitë ditore	0	14.652	-	17.201	21.571	25,4
4. Trajtim shëndetësor	84	25	-70,2	180	66	-63,3
5. Qëllime fetare	61	35	-42,6	132	129	-2,3
6. Vizitorë të tjerë	160.153	186.860	16,7	429.850	509.052	18,4
7. Udhëtarë transit	10.141	11.843	16,8	25.404	30.443	19,8
II. Biznes dhe profesionale	5.467	6.309	15,4	12.113	15.380	27,0

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Mars 2017	87.908	25.118	471.754	87.735	27.632	518.527
Mars 2018	97.923	24.864	484.500	93.320	22.581	483.091
Ndryshimi vjetor (%)	11,4	-1,0	2,7	6,4	-18,3	-6,8
Janar-Mars 2017	247.844	69.040	1.200.543	260.097	106.023	1.307.496
Janar-Mars 2018	275.917	66.653	1.363.725	285.034	87.861	1.447.505
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	11,3	-3,5	13,6	9,6	-17,1	10,7

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>